



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA MALËSI E MADHE**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHERBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Koplik , më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ .2026

**SHPLLJE PËR VEND VAKANT PUNE**

Në zbatim të nevojave të institucionit dhe në kuadër të masave për parandalimin dhe monitorimin e zjarreve gjatë sezonit veror, Bashkia Malësi e Madhe shpall hapjen e procedurës së aplikimit për pozicionin:

“Punonjës Pastrimi” (me kontratë të përkohshme 5-mujore)

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

Punonjësi i pastrimit do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës në ambientet publike dhe/ose institucionet në administrim të Bashkisë Malësi e Madhe, në përputhje me standardet dhe rregulloret në fuqi.

2. Detyrat kryesore:

- Kryen shërbime pastrimi në zonat dhe ambientet e përcaktuara
- Siguron mirëmbajtjen e vazhdueshme të higjienës
- Zbaton rregullat e sigurisë dhe higjienës në punë
- Kryen detyra të tjera sipas udhëzimeve të eprorit

### 3. Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar
- Të ketë gjendje të mirë shëndetësore dhe aftësi fizike për punë
- Të karakterizohet nga korrektësia, përgjegjshmëria dhe disiplina në punë
- Eksperienca e mëparshme në punë të ngjashme përbën avantazh

### 4. Kohëzgjatja e kontratës:

Kontratë pune e përkohshme me afat 5 (pesë) muaj

### 5. Orari i punës:

Sipas organizimit dhe nevojave të institucionit

### 6. Dokumentacioni i kërkuar:

- Kërkesë për aplikim
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID)
- Curriculum Vitae (CV), nëse disponohet
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së mesme
- Vërtetim Banimi
- Raport Mjeko-Ligjor
- Dëshmi Penaliteti
- Numer llogarie Bankare

### 7. Afati dhe mënyra e aplikimit:

Të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin brenda datës 12 / 05 / 2026, pranë zyrave të Bashkisë Malësi e Madhe ose në adresën elektronike zyrtare të institucionit.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen nga Institucioni.